

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Incidentet në Baltik rrisin tensionet mes Rusisë dhe NATO-s: Sjellje provokuese nga rusët, droni... Top Albania Radio
ADRESA	https://www.topalbaniaradio.com/incidentet-ne-baltik-rrisin-tensionet-mes-rusise-dhe-nato-s-sjellje-provokuese-nga-ruset-droni/
BURIMI	topalbaniaradio.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 17:35:37 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 17:30:53 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	aee43e903b40df939986d1e3bb60eca63f692feb38b55b4351d61900c09e1a8c
TEKSTI	12b9b0bff604418c2c72ec6994a52c5b91ea3600b1c320ab82a0ae05d5398dc0
PAMJA	0ee1d193ab9249a876671e0f5b2a1cc98bc809de2321eae56eadfae466eb6291

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	184782817a340051729f65cfaa44b76e5df99866a43ffc22d29506e0e4ef07c9
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	80f8ed3d4c77708449a259db492a6c9a12b9addcfc62e639a2bd2cb31edd1709
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/184782817a340051729f65cfaa44b76e5df99866a43ffc22d29506e0e4ef07c9>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Bota

Incidentet në Baltik rrisin tensionet mes Rosisë dhe NATO-s: Sjellje provokuese nga rusët, droni...



Edi Hallaci

15 Shtator 2026



TOP ALBANIA RADIO

Një anije luftarake ruse qëlloi dy fishekjarrë drejt një helikopteri ushtarak danez në Detin Baltik, ndërsa avionët luftarakë të NATO-s rrëzuan një dron me një pajisje shpërthyesë mbi Lituani. Incidentet kanë nxitur shqetësim në Evropë dhe akuza për sjellje provokuese nga Rusia.

Një fregatë ruse lëshoi dy sinjale emergjence drejt një helikopteri Fennec të forcave ajrore daneze gjatë një operacioni rutinë fotografik në ujërat ndërkombëtare pranë Danimarkës jugore. Sipas autoriteteve daneze, një nga fishekjarrët kaloi vetëm pak metra nga helikopteri.

Ministri danez i Mbrojtjes, Jeppe Bruus, tha se para incidentit nuk kishte pasur asnjë paralajmërim apo kontakt radioje me anijen ruse. Sipas tij, helikopteri po ndiqte procedurat standarde për fotografimin e fregatës, një nga aktivitetet që ishte kryer edhe më parë.

Ministri i Jashtëm danez, Lars Løkke Rasmussen, deklaroi se kishte thirrur ambasadorin rus në Danimarkë për të kërkuar shpjegime. Ai e cilësoi veprimin si të papranueshëm dhe paralajmëroi se sjellje të tilla mund të vënë në rrezik jetë njerëzish.

Nga ana tjetër, ambasadori rus në Danimarkë, Vladimir Barbin, e paraqiti incidentin ndryshe. Ai pretendoi se helikopterët danezë kishin kryer më parë manovra të rrezikshme pranë anijeve luftarake ruse dhe i akuzoi ato për veprime provokuese.

Në një incident tjetër, një dron hyri në hapësirën ajrore të Lituanisë dhe u rrëzua nga avionët luftarakë të NATO-s. Droni ra pranë fshatit Pratkūnai, rreth 100 kilometra në perëndim të Vilniusit.

Autoritetet lituaneze thanë se droni kishte qëndruar rreth 30 minuta në hapësirën ajrore të vendit dhe kishte fluturuar pranë zonave të populluara përpara se të interceptohej. Sipas qendrës kombëtare të menaxhimit të krizave, ai ka shumë të ngjarë të ketë hyrë nga territori i Bjellorusisë.

Gjatë kërkimeve në zonën ku ra droni, autoritetet zbuluan një pajisje shpërthyes, e cila më pas u neutralizua. Ministri italian i Mbrojtjes, Guido Crosetto, tha se droni kishte shumë gjasa të kishte ardhur nga Rusia.

Presidenti i Lituanisë, Gitanas Nausėda, e cilësoi reagimin e avionëve të NATO-s si të rëndësishëm për sigurinë e rajonit, veçanërisht në një kohë kur Rusia po intensifikon luftën kundër Ukrainës.

Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, tha se incidentet në Danimarkë dhe Lituaninë nuk duhet të konsiderohen si ngjarje të izoluara. Sipas saj, ato janë pjesë e një modeli më të gjerë të agresionit dhe provokimit rus ndaj Evropës.

Von der Leyen theksoi se këto zhvillime po testojnë gatishmërinë dhe vendosmërinë e vendeve evropiane dhe shtoi se përgjigjja e Evropës ndaj këtyre veprimeve do të jetë gjithnjë e më e vendosur.

Kryeministrja daneze, Mette Frederiksen, dënoi gjithashtu atë që e cilësoi si veprim të pamatur të Rusisë ndaj ushtrisë daneze. Sipas saj, veprimet ruse synojnë të frikësojnë dhe të përçajnë Evropën.

LAJME TË NGJASHME



Helikopteri u rrëzua dhe më pas shpërtheu në flakë/ Flet xhaxhai i pilotit britanik që shpëtoi mrekullisht nga tragjedia në Greqi!

2.5 MIN



Historia e pilotit danez që gjeti vdekjen gjatë shuarjes së zjarreve në Greqi!

2 MIN



Helikopteri ushtarak amerikan rrëzohet pranë Ngushticës së Hormuzit, droni shpëton dy pilotët

1.5 MIN



Bllokimi i Librazhd-Pogradec, Rama: Ligësi e madhe t'i faturosh qeverisë problematikën e një rrëshqitjeje gjeologjike!

3.5 MIN



Rrëzohet helikopteri gjatë stërvitjes në Korenë e Jugut, humbin jetën dy ushtarë

1 MIN

MË TË LEXUARAT



Biletat për ndeshjet e Shqipërisë, edhe fizikisht pranë "Air Albania"-s!



Arrest i Erion Veliajt, sot çështja në Gjykatën e Lartë!



"Burri e tradhtonte me shokun e ngushtë..."/ Shkënda Lili habit me rastin: Kishte kapur disa foto intime në...



Rrëzohet kërkesa e Ilir Metës për lirim nga burgu!



Oasis nuk ndalen! Liam dhe Noel Gallagher rikthehen sërish në skenë me 38 koncerte?





Kujtimet në Top Channel dhe dashuria për ekranin, "rikthehet" Albana Osmani: Do të doja të bashkëpunoja me Ledionin...



Sydney Sweeney pozon nudo për reklamën e re dhe shpërthen polemika? "Po seksualizohet sporti..."



Për kë vazhdon të blejë lule te dyqani i motrës së Stelinës? Miri zihet ngushtë: Për atë...



Makina përplas 69-vjeçarën me biçikletë, ndërron jetë rrugës për Tiranë!



"E ëma e qëlloi me gur për ta vrrarë", Pastor Vilajeti rrëfen historinë e fëmijës që shpëtoi!

EDITORI SUGJERON



"Po du", Rilind Alimani tregon si arriti të realizojë bashkëpunimin me Elvana Gjatën: I kam shkruar që...



"Eksperimentova, shkoi shumë mirë"/Egri Tako flet për projektet e saj muzikore: Do kthehem tek baladat...



Sasia ideale e proteinave që duhet të hani në mëngjes, sipas një dietologu...



4 kardiologë tregojnë ushqimet që konsumojnë rregullisht për të ndihmuar në uljen e tensionit dhe...



7 ilaçe që mund të ndërveprojnë me çajin jeshil?!



Tom Holland bën histori në Hollywood, bëhet aktori me filmat më fitimprurës të të gjitha kohërave!



Pyetëm një dietolog nëse yndymat e kikirikëve janë të mira për zemrën?! Ja se çfarë tha...



"Seven Up!" i jep lamtumirën kamerës pas 62 vitesh, fëmijët që u filmuan në moshën 7-vjeçare festojnë 70-vjetorin!



Çfarë mund të ndodhë nëse hani avokado rregullisht?!



Cili është lloji më i mirë i drithërave për të ulur kolesterolin?!

RRETH NESH

Top Albania Radio promovon muzikën më të zgjedhur shqiptare dhe të huaj, me edicionet informative dhe një larmi programesh kulturore.

KONTAKT

Address: Sheshi Italia 1, Arena Center, Tirana, Albania
Email:

COPYRIGHTS

Përmbajtja e këtij website është pronë e Top Albania Radio. Kopjimi, përdorimi apo riprodhimi i paautorizuar i tij, përbën shkelje

LINKS

Kontakti
Marketing
Frekuencat

27 vjet transmetim, për të dhënë më të mirën.

penale.

Aksesueshmëria
Mundësi Punësimi
Privacy Policy & Terms

Tel: +355 69 208 0500
+355 69 442 8873

JavaScript is required for [tabnav widget](#) to work properly.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.